

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

ZYRA E SUPERINTENDENTIT

440 NORTH BROAD STREET, SUITE 301
PHILADELPHIA, PENNSYLVANIA 19130

WILLIAM R. HITE, JR., Ed.D.
SUPERINTENDENT

19 Qershor 2017

Të dashur Prindër, Kujdestarë dhe Familjarë,

Çfarë viti shkollor i shkëlqyer! Eshtë shumë e vështirë të besohet që viti shkollor 2016 – 2017 është në përfundim. Urime të gjitha familjeve, që do të festojnë arritjet e këtij viti. Maturantët e shkollave të mesme janë duke u diplomuar dhe përgatiten për kapitullin e ardhshëm të jetës, nxënësit e klasave të teta janë duke menduar se si do të jetë në shkollën e mesme dhe ata të klasave të pesta pyesin veten se si do të mbushin korridoret e shkollave të tyre tetëvjeçare.

Nxënësit tanë na frymëzojnë dhe na bëjnë krenar çdo ditë. Përprjekjet dhe arritjet e tyre janë prova të përkushtimit të prindërve tanë, personelit të shkollave dhe komunitetit. Personeli jonë ka qenë i përkushtuar në kujdesin ndaj fëmijëve tuaj si individë dhe nxënës, duke ju ofruar të gjithë nxënësve programet mësimore më cilësore. Kjo ka qenë e pranishme çdo ditë në klasat tona, në autobuzët e shkollave, në kafeteri, në performancat muzikore, në seminarët shkencore, në fushat sportive, në vjetarin e shkollave dhe kudo.

Prindër, kujdestarë dhe pjestarë të familjeve, ju falenderojmë për mbështetjen dhe përfshirjen tuaj. Forca e bashkëpunimit tuaj ishte e jashëzakonshme për komunitetet tona shkollore— ne ju jemi mirënjohës për kohën dhe talentet tuaja. Mbështetja emocionale dhe mësimore e kërkesave të nxënësve tanë, me të vertetë kërkon një bashkëpunim të familjeve dhe shkollave.

Me stinën e verës në prag, Unë e di se keni bërë plane për pushimet dhe aktivitetet verore të fëmijëve tuaj. Gjithësesi, një shkopje nga aktivitetet shkollore shpesh i shkakton nxënësve një harresë të mësimave, kur kthehen në shkollë përsëri në vjeshtë. Ju lutemi, vazhdoni të punoni me fëmijët tuaj gjatë stinës së verës: lexoni bashkë me ta, e vini fëmijën të numërojë monedhat në kutinë e tij të kursimeve, e nxisni atë të bëjë zgjedhje dhe të jetë me ju gjatë blerjeve të ushqimeve të përditëshme dhe për sjellje të mira sociale dhe përshtetjesh shoqërore. Filadelfia ofron shumë mundësi mësimi dhe Unë ju inkurajoj t'i përdorni këto mundësi dhe të gëzoni kohën me fëmijën tuaj gjatë kësaj stine verore.

Viti shkollor 2017 – 2018 është e sigurtë që do të jetë plot me aventura të reja eksituese. Dita e parë e shkollës është data 5 Shtator. Prindërit ose kujdestarët duhet t'i regjistrojnë fëmijët të cilët do të jenë 5 vjeç, ose më shumë deri në 1 Shtator, në klasat e kopështit.

Deri atëhere, Unë ju uroj ju dhe fëmijës tuaj një stinë verore të sigurtë, të lumtur dhe të gëzuar!

Sinqerisht,

William R. Hite, Jr., Ed.D.